



Republika e Shqipërisë

Bashkia Belsh

Drejtoria Arkiv-Protokoll dhe Arsim

PLANI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Përmbajtja

1-Parathënie.....	1
• Hyrje	1
2- Vizioni,Qëllimet Strategjike,Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për Përmirësimin e Arsimit Parauniversitar.....	2
• Vizioni.....	2
• Qëllimi.....	2
3- Kuadri I përgjithshëm ligjor Arsimit Parauniversitar.....	3
4- Profili demografik dhe social I Bashkisë Belsh.....	4
• Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor.....	4
5- Analiza e shërbimit të Arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	5
• Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor.....	5
• Regjistrimi I fëmijëve në Kopshte.....	5
• Reduktimi I grupeve te perziera.....	5
6- Analiza e shërbimit në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024-2025	
Mbulimi I ofrimit të shërbimit të Arsimit.....	6
7-Shërbimi I Arsimit sipas njësive Administrative.....	7
8- Arsimit I Mesem I Përgjithshëm.....	
• Qëllimi I planit në arsimin e mesem të përgjithshëm.....	8
• Objektivat Specifike.....	8
9 -Buxheti.....	9
10-Përfshirja Sociale.....	10
11- Monitorimi dhe vlerësimi.....	11

Plani i Arsimit Parauniversitar për Bashkinë Belsh (2025–2028)

1. Parathënie

Bashkia Belsh, në përputhje me vizionin e saj për të ndërtuar një komunitet të qëndrueshëm, të drejtë dhe të zhvilluar, i kushton vëmendje të veçantë arsimit si një shtyllë themelore për të ardhmen e fëmijëve dhe të vetë zhvillimit shoqëror. Përkushtimi ynë ndaj një arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë reflektohet qartë në këtë plan të Arsimit Parauniversitar 2025-2028

Ky plan është ndërtuar mbi tri shtylla kryesore:

1-Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës, nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, përmirësimit të kushteve higjieno-sanitare, pajisjes me mjete didaktike dhe funksionimit të shërbimeve mbështetëse;

2-Zhvillimi i plotë i fëmijëve, përmes përkujdesjes së integruar, fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukues dhe garantimit të mbështetjes për fëmijët në nevojë apo me aftësi të veçanta;

3-Nxitja e pjesëmarrjes, talentit dhe ndjesisë së përkatësisë, përmes veprimtarive edukative, kulturore dhe ndërgjegjëse të zhvilluara gjatë gjithë vitit shkollor.

Në bashkëpunim me institucionet arsimore, komunitetin lokal, prindërit dhe partnerët e zhvillimit, Bashkia Belsh synon të garantojë një sistem arsimor që i përgjigjet standardeve bashkëkohore dhe nevojave konkrete të çdo fëmije, pa përjashtim.

Ky plan është hartuar me përkushtim dhe profesionalizëm, duke u mbështetur në të dhëna konkrete, standarde kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në konsultime me aktorët lokalë. Zbatimi i tij do të kërkojë angazhim të vazhdueshëm, bashkëpunim të ndërsjellë dhe monitorim të kujdesshëm për të siguruar një ndikim pozitiv dhe afatgjatë.

Bashkia Belsh rikonfirmon angazhimin e saj të palëkundur për t'i ofruar çdo fëmije një arsimit dinjitoz, të drejtë dhe të barabartë, si themel për zhvillimin e tij personal dhe për të ardhmen e komunitetit tonë.

Hyrje

Sistemi arsimor perben nje nder shtyllat kryesore te zhvillimit shoqeror dhe ekonomik te nje vendi. Arsimi parashkollore baze dhe I mesem luajne nje rol themelore ne formimin e individit, zhvillimin e kompetencave personale dhe profesionale, si dhe ne ndertimin e nje shoqerie te qendrueshme dhe te integruar.

2. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për Përmirësimin e Arsimit Parauniversitar.

Vizioni

“Të sigurojmë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Belsh, akses në arsim Parauniversitar gjithëpërfshirës, cilësor dhe të drejtë, të zhvilluar në mjedise të sigurtë dhe të përshtatshme me mesazhet e përgatitjes dhe mbështetjes të vazhdueshme duke trajnuar arsimin sipas shtyllave themelore për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit. Forcimin e barazisë dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore dhe institucionale.

Përmbledhja e Qëllimeve, Objektiveve dhe Aktiviteteve

Duke u mbështetur në rrjetin ekzistues të institucioneve arsimore, nga kopshtet deri në shkollat e mesme dhe duke adresuar sfidat aktuale të aksesit, infrastruktures dhe përfshirjes gjinore, Bashkia Belsh ka për synim:

- Përmirësimin e infrastruktures arsimore, veçanërisht në zonat rurale, për të garantuar kushte dinjitoze, mesimi në çdo shkollë dhe kopsht.
- Përmirësimin e përfshirjes në arsimin parashkollor, duke mbështetur prindërit dhe rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e edukimit të hershëm.
- Zvogelimin e pabarazive gjinore dhe sociale në ndjekjen e shkolles në të gjitha nivelet e Arsimit Parauniversitar.
- Rritjen e cilësisë së mesimdhënies përmes investimit në zhvillimin profesional të mesazheve dhe përdorimi të metodologjive bashkëkohore.
- Forcimin e partneriteteve me komunitetin dhe institucionet arsimore për të mbështetur suksesin e çdo nxënësi.

Qëllimi

1.Sigurimi I nje mjedisi arsimor të sigurt,funksional dhe gjithëpërfshirës.

Të garantohen kushtet të qendrueshme infrastrukturore dhe funksionale për të gjitha institucionet arsimore ne Territorin e Bashkise Belsh,permes mirembajtjes sistematike dhe investimeve te orientuara drejt standarteve bashkekohore.

- **Objektivi 1.1**-Të sigurohet ofrimi I sherbimeve mbeshtetese në menyre te vazhdueshme dh efektive,duke perfshire pagesat epersonelit mesues ne Arsimin Parashkollor dhe Personelin Ndihmes ne Kopshte dhe Shkolla,mirembajtjen e Ambienteve shkollore,permiresimin e kushteve higjeno-sanitare,funksionimin e sistemeve te ngrohjes,furnizimin me kancelari,mjete didaktike.
- **Objektivi 1.2**-Te investohet ne permiresimin e infrastruktures arsimore permes ndertimit ose rikonstruksionit te kopshteve dhe institucioneve arsimore,ngritjes te nje sistemi elektronik per regjistrimin dhe menaxhimin e te dhenave te institucioneve arsimore.

Qellimi 2(Q2) Mbështetje per zhvillimin e plote te femijeve permes edukimit cilesor dhe perkujdesjes se integruar

Te sigurohet zhvillimi emocional,social dhe kognitiv I cdo femije permes sherbimeve educative gjitheperfshirese dhe mbeshtetjes psiko-sociale ne mjedise te sigurta dhe perkujdesese.

- **Objektivi 2.1**-Te permiresohet cilesia e edukimit ne insitucionet parashkollore permes mbeshtetjes se kopshteve me mjete dhe organizimit te trajnimeve per edukatoren dhe ngritjes se kapaciteteve te stafit per te ofruar nje edukim te hershem gjithperfshirese dhe bashkekohor.
- **Objektivi 2.2**-Te forcohet perkujdesja sociale per femijet permes angazhimit te mesuesve ndihmes,ofrimit te sherbimeve psiko-social,krijimit dhe fuqizimit te strukturave menaxhuese pjesemarrese (keshillat e prinderve dhe burdet e shkolles),si dhe mbeshtetjes se nxenesve nga femijet ne nevoje apo me rezultate te larta.

Qëllimi 3(Q3) Zhvillimi I talenteve dhe njesise se perkatesise permes veprimtarive jashtemesimore

Te promovohet zhvillimi I potencialit krijues,fizik dhe social te femijeve permes nje kalendari te pasur aktiviteteve jashtemesimore qe nxisin shendetin,bashkepunimin dhe perfshirjen komunitare.

- **Objektivi 3.1**-Te organizohen rregullisht veprimtari kulturore,sportive dhe ndergjegjesuese,si:ngjarje artistike,ekzpozita,dite nderkombetare tematike ,aktivitet mjedisore dhe locale,per te nxitur zhvillimin e aftesive dhe pjesmarrjen aktive te femijeve ne jeten shoqerore.

3. Kuadri I përgjithshëm ligjor Arsimi Parauniversitar

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë- neni 57,pika 1**
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026
- Plani Kombëtar I Veprimit për Barazi,Perfshirje dhe Pjesëmarrje e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025)& Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021-2026)
- **Ligji Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"**:Ky ligj përcakton strukturën dhe funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar në vend.Ai garanton të drejtën kushtetuese për arsimim dhe rregullon funksionimin e këtij sistemi.
- **Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**
Neni 23:Funksionet e bashkive në fushën e infrastruktures dhe shërbimeve publike.
1.Ndërtimin,rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtësive arsimore të sistemit shkollor parauniversitar,me përjashtim teshkollave profesionale.
2.Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe cerdher
- **Ligji nr.68/2017"Per financat e vetëqeverisjes vendore"**
- **Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore",I ndryshuar;**
- **Ligji 115/2024,"Per Buxhetin e viti 2025".**
- **Ligji Nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"**
- **Ligji Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"**

- **Kuadri ligjor dhe politika që percakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e Arsimit në nivel vendor.**

Në Bashkinë Belsh, detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e Arsimit parauniversitar mbështeten në kuadrin ligjor dhe politik kombëtar që rregullon funksionimin e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë. **Ligji nr.69/2012 “Per sistemin arsimor parauniversitar”**, I ndryshuar, percakton strukturën dhe përmbajtjen e Arsimit në të gjitha nivelet-përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe professional-si dhe detyri net e institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për garantimin e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.

Përveç tij, Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” I ka ngarkuar njësitë të vetëqeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë Belsh, kompetenca të drejtpërdrejta në ofrimin e shërbimeve të Arsimit parashkollor. Bashkia është përgjegjëse për ndertimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e kopshteve publike në territorin e saj, përfshirë sigurimin e infrastruktures, furnizmit dhe stafit ndihmes. Për arsimin bazë dhe të mesëm, edhe pse kompetencat kryesore i përkasin Ministrës së Arsimit dhe strukturave të saj vendore, Bashkia ka një rol të rëndësishëm mbështetës, veçanërisht në menaxhimin e infrastruktures, mbështetjen e transportin e nxenesve, aksesit për fëmijet me nevojë të vecanta dhe sigurisë në institucionet arsimore.

Në zbatim të këtyre detyrimeve, Bashkia Belsh harton dhe zbaton politika vendore për arsimin, të cilat janë të orientuara nga prioritetet kombëtare dhe nevojat lokale. Këto politika janë të integruara në dokumente strategjike si **Plani I Përgjithshëm Vendor, Plani Social 2024-2026**, si dhe dokumente specifike për sektorin e Arsimit, ku pasqyrohen nevojat infrastrukture, numri dhe shpërndarja e fëmijëve në territor, burimet njerezore, përfshirja e grupeve vulnerable dhe bashkëpunimi me komunitetin e prindërve dhe partnerëve të tjerë.

Gjithashtu Bashkia Belsh bashkëpunon ngutësisht me **Zyren Vendore Arsimore (ZVA)** dhe institucionet arsimore publike për të garantuar koordinimin institucional në zbatimin e politikave dhe standarteve arsimore, përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për nxenesit. Ky bashkëpunon mundëson ndërhyrje të përbashkëta në rastet që lidhen me rikonstruksionin e objekteve shkollore, menaxhimin e emergjencave, regjistrimet në institucione arsimore dhe përfshirjen e fëmijëve që rrezikojnë të mbeten jashtë sistemit arsimor. Në këtë mënyrë, Bashkia Belsh vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore në territorin e saj, duke kontribuar në sigurimin e një Arsimi cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë fëmijet dhe të rinjtë në territor.

4.Profili demografik dhe social I Bashkisë Belsh

Bashkia Belsh ndodhet në qarkun e Elbasanit dhe përfshin një numër njësisish administrative me popullsi kryesisht rurale. Migrimi i brendshëm dhe jashtë vendit ka ndikuar në uljen e numrit të nxënësve në disa shkolla. Në Bashkinë Belsh kemi gjithsej 15 shkolla, ku njera prej tyre është gjimnaz I përgjithshëm. Në arsimin Parashkollor janë 25 grupe me fëmijë. Kopshti Publik ndodhet në qytetin e Belshit ku përbehet nga 6 grupe paralele dhe pjesa tjetër janë grupe të perziera, ku disa prej këtyre grupeve ndodhen brenda ambjentëve të shkollave.

Frekuentimi në arsimin bazë dhe të mesëm gjatë vitit 2024-2025 nga moshë 6-18 janë 1352. Për vitin 2025-2026 parashikohet të jenë 1305 nxënës.

Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:

Plani bazohet në Ligjin Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 dhe udhëzimet e MAS. Ai është në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me prioritetet e qeverisjes vendore për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Bashkia Belsh përfshin një numër njësisish Administrative ku secila prej tyre ruan rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Bashkia Belsh është e përbërë nga 5 Njësi Administrative. Këto njësi janë të ndërthurura ndërmjet zonave urbane dhe rurale.

Njësitë Administrative janë:

- **Njësia Administrative Belsh**
- **Njësia Administrative Kajan**
- **Njësia Administrative Grekan**
- **Njësia Administrative Fierzë**
- **Njësia Administrative Rrasë**

Këto njësi përbejnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë Arsimin Parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

Më poshtë do të gjeni numrin total të popullsisë të fshatrave të Bashkisë Belsh :

Njësia Administrative Belsh

Emri I Fshatit/ Njësia Adm Belsh	Numri I Popullsisë	Numri I Familjeve
Qender Belsh	2,975	967
Marinëz	1,376	359
Gradisht	1,271	364
Dushk	1,197	319
Shkëndi	1,195	367
Trojas	1,092	339
Seferan	1,304	356
Qafëshkalle	1,157	354
Belsh Hysë	1,058	360
Shkozë	927	273
Cepe	789	219
Stanaj	503	212
Shtith	497	149
Shuma	15,341	4,638

Njësia Administrative Kajan

Emri I Fshatit/ Njësia Adm Kajan	Numri I Popullsisë	Numri I Familjeve
Dragot	738	260
Lisaj	369	117
Kajan	1,229	365
Dragot Kooperativë	986	343
Gjinuk	447	201
Gjolen	908	239
Turbull	812	188
Cestije	639	176
Merhojë	307	107
Idrizë	318	86
Shuma	6,753	2,082

Njësia Administrative Grekan

Emri I Fshatit/ Njësia Adm Grekan	Numri I Popullsisë	Numri I Familjeve
Dëshiran	2,366	652
Grekan	1,212	434
Guras	789	267
Rrenas	766	309
Shuma	5,133	1,662

Njësia Administrative Fierzë

Emri I Fshatit/ Njësia Adm Fierzë	Numri I Popullsisë	Numri I Familjeve
Fierze	1,215	394
Hardhi	774	240
Cerrage	911	276
Kosove	1,093	322
Shuma	3,993	1,232

Njësia Administrative Rrasë

Emri I Fshatit/ Njësia Adm Rrasë	Numri I Popullsisë	Numri I Familjeve
Shegas	426	162
Rrasë e poshtme	601	187
Guri Bardhe	519	163
Rrase e sipërme	866	277
Shuma	2,412	789

- Belshi paraqitet si njesia me e populluar me gjithsej 15,341 banorë.
- Njësia administrative Kajan renditet e dyta per nga numri I popullsisë 6753 banore.
- Njësia administrative Grekan renditet e treta per nga numri I popullsisë me 5133 banore.
- Njesia administrative Fierze renditet e katerta per nga numri I popullsisë me 3993 banore.
- Njesia administrative Rrase renditet si nje nga njesite me te vogla per 2412 banore.

5.Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Belsh shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njesive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Belsh funksionojnë 20 godina kopshtesh të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

Numri i fëmijëve të rregjistruar në arsimin parashkollor nga mosha **3-6** për vitin **2024-2025** është **259** fëmijë ku **111** janë femra dhe **148** janë meshkuj.

Mbështetur në planin afatëmesëm parashikimi për vitin **2025-2026** është **223** fëmijë nga mosha **3-6** vjec.

Më poshtë po paraqesim tabelen me numrin e kopshteve për cdo njësi Administrative të Bashkisë Belsh.

Njësia Administrative	Numri I kopshteve
Belsh	9
Kajan	4
Grekan	3
Fierze	2
Rrasë	1

Frekuentimi në kopshte.

Emri I Kopshtit	Fëmije të rregjistruar 2024-2025	Fëmije që parashikohen për vitin 2025-2026
Belsh Qender	42	36
Belsh qender Godina Shkolla e Mesme	54	53
Hysë	5	2
Qafeshkalle	4	6
Shkoze	5	3
Rrase	14	12

Shkendi	6	4
Shtith	2	0
Seferan	9	12
Fierze	16	19
Kosove	18	10
Grekan	15	8
Rrenas	5	5
Deshiran	17	18
Marinez	7	4
Dushk	8	7
Gjolene	5	1
Kajan	11	11
Dragot	11	7
Turbull	5	5
Totali	259	223

Qëllimi i Planit:

Të përmirësojë cilësinë dhe aksesin në arsim për të gjithë fëmijët e Bashkisë Belsh, në moshë shkollore pavarësisht vendbanimit apo gjendjes ekonomike.

Prioritetet kryesore:

- Zhvillimi i infrastrukturës shkollore rurale.
- Përfshirja e fëmijëve nga grupet vulnerabël.
- Trajnimi i mësuesve për metodologji moderne.
- Mbështetja e arsimit profesional

Objektiva kryesore:

Planifikimi i sistemit parashkollor duke u bazuar në numrin e parashikuar të fëmijëve të moshës 3-6 vjeç, normën e regjistrimit të pritur dhe shkallën e frekuentimit, për të ofruar një shërbim të efektshëm dhe të qëndrueshëm.

Nën-objektivat:

Nr	Pershkrimi
1	Planifikimi dhe parashikimi për regjistrimin dhe akomodimin e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në kopshtet, duke marrë parasysh numrin e pritur të fëmijëve, normën e regjistrimit dhe shkallën e frekuentimit për të siguruar shërbim efikas dhe të qëndrueshëm.

Nr	Pershkrimi
2	Rregullimi i procedurës së regjistrimit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të akteve formale.
3	Rritja e regjistrimit të fëmijëve në kopshte të cilat kanë numër të ulët fëmijësh
5	Ulja e numrit të grupeve të përzier

Të dhënat e regjistrit të shërbimit;

Numri	Indikatori	Shperndarja gjeografike	Fakt aktual	Plan viti 2024	Plan viti 2025	Plan viti 2026
001	Femije ne grupin e I	Bashkia Belsh	28	28	25	30
001	Femije ne grupin e II	Bashkia Belsh	33	33	29	28
001	Femije ne grupin e III	Bashkia Belsh	40	40	33	33
001	Femije ne grupe te perziera	Bashkia Belsh	158	158	140	120

Regjistrimi i fëmijëve në Kopshte

2

Informacion i përgjithshëm

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Nenin 23, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e tyre për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Ky ligj u jep bashkive të drejtën për të planifikuar, financuar dhe organizuar funksionimin e kopshteve. Po ashtu, bashkitë kanë të drejtën për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje, si dhe standarde të detyrueshme për funksionimin e kopshteve, në përputhje me ligjin.

Ne Bashkine Belsh jane 20 kopshte ku 14 prej tyre ndodhen Brenda godinave te shkollave.

Grupe gjithsej jane 25.

Femije gjithsej 259 ku femra 111 dhe meshkuj 148

Reduktimi i grupeve të përziera

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e menaxhimit të kopshteve.
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe zbatimi i ligjit për drejtimin e kopshteve.
5. Rikonstruksioni i kopshteve në bazë të një vlerësimi teknik.

6. Analiza e shërbimit në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024-2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të Arsimit.

Në Bashkinë Belsh jane 15 institucione arsimore te niveleve te ndryshme, te cilat mbulojne te gjitha njesite administrative, urbane dhe rurale. Keto institucionet perfaqesojne nje rrjet te gjere dhe te larmishem te Arsimit parauniversitar. Shkollat ne territorin e Bashkise Belsh jane te organizuara dhe te shperndara ne menyre te tillë qe te mbulojnesa me mie nevojat arsimore te komunitetit. Ata klasifikohen ne disa nivele sipas ciklit te edukimit qe ofrojne, duke perfshire: shkolla fillore 0, shkolla 9-vjecare (12 + 2ShB gjithsej) dhe shkolla te mesme (1 -një).

- **Shkollat 9-vjecare**, gjithsej 12 në numër, përfshijnë si në ciklin fillor, ashtu dhe të mesëm të ulët dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- **Shkolla e mesme**, në numër prej 1, është shkollë që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare, përgatitje për tregun e punës.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë Belsh është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijet dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.

7. Shërbimi i Arsimit bazë sipas njësive administrative

Njësia Administrative: Belsh

Shkollat

Në këtë njësi funksionojnë gjithsej 7 shkolla, të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nder to 6 janë shkolla 9-vjecare të cilat ofrojnë ciklin bazë të Arsimit dhe 1 është shkollë e mesme. Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë akses të qëndrueshëm në arsimin për fëmijet e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu dhe në ato periferike apo rurale.

Emri i shkollës	Tipi i Shkolles	Numri i femijeve	Femra	Meshkuj
"Sami Frashëri"	Shkolla e mesme e përgjithshme	227	124	103
"Halit Uruci"	9-Vjecare	388	184	204
"Tahir Musta"	9-Vjecare	24	11	13
"Isuf Dervishi"	9-Vjecare	27	9	18
"Abdy I Tafani"	9-Vjecare	34	21	13
"Ramadan Kasa"	9-Vjecare	62	28	34
"Ramadan Idrizi"	9-Vjecare	48	20	28

Njësia Administrative Kajan

Në këtë njësi funksionojnë 3 shkolla të Arsimit 9-vjeçarë.

Emri i Shkolles	Tipi i Shkolles	Numri i Femijeve	Femra	Meshkuj
"Jashar Dunga"	9-vecare	81	35	46
Dragot	9-vjecare	82	52	30
"Bajram Senja"	9-vjecare	21	8	13

Njësia Administrative Grekan

Në këtë njësi administrative kemi 2 shkolla, ku na këto shkolla 1 është shkollë 9-vjeçarë + 1 SHB.

Emri i Shkolles	Tipi i Shkolles	Numri i femijeve	Femra	Meshkuj
SHB "Hekuran Bezati"	SHB	43	19	24
Grekan	9-vjecare	101	52	49

Njësia Administrative Fierzë

Në këtë njësi administrative kemi 2 shkolla, ku na këto shkolla 1 është 9-vjeçarë + 1 ShB.

Emri i Shkolles	Tipi i Shkolles	Numri i fëmijeve	Femra	Meshkuj
SHB Kosovë	SHB	52	19	33
Fierze	9-vjecare	69	27	42

Njësia Administrative Rrasë

Emri I Shkolles	Tipi I shkolles		Numri I femijeve	Femra	Meshkuj
"Ibrahim Daullja"	9-vjecare		82	52	30

Më poshtë është paraqitur një tabelë me të dhënat e shkollave të shpërndara në njësi administrative, si dhe numri total i fëmijëve për çdo shkollë.

Nr.	EMRI I SHKOLLËS	Vendbanimi	Njësi Administrative	ZVAP	Numri total i fëmijëve
1	Shkolla 9-vjeçare "Halit Uruci"	Belsh	BELSH	BELSH	388
2	Gjimnazi "Sami Frasheri"	Belsh	BELSH	BELSH	227
3	SHB Kosove	Kosove	FIERZE	BELSH	52
4	Fierzë	Fierzë	FIERZE	BELSH	69
5	Grekan	Grekan	GREKAN	BELSH	101
6	Jashar Dunga	Kajan	GREKAN	BELSH	81
7	Dragot	Dragot	KAJAN	BELSH	82
8	Ramadan Kasa	Seferan	BELSH	BELSH	62
9	Ibrahim Daullja	Rrasë	RRASE	BELSH	70
10	Ramadan Idrizi	Dushk	BELSH	BELSH	48
11	ShB "Hekuran Bezati"	Dëshiran	GREKAN	BELSH	43
12	Tahir Musta	Shkëndi	BELSH	BELSH	24
13	Isuf Dervishi	Qafshkallë	BELSH	BELSH	27
14	Abdyl Tafani	Marinz	BELSH	BELSH	34
15	Bajram Senja	Gjolenë	KAJAN	BELSH	21

Qëllimi është garantimi i te drejtës për arsimin cilësor, pa përjashtim dhe krijimi i një mjedisi të sigurt, gjithpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë fëmijët.

Ne Bashkinë Belsh ka 21 femije nga komuniteti egjiptian që frekuentojne shkollen ndërsa femije te komunitetit rom nuk ka.

8.Arsimi i mesëm i përgjithshëm:

Në Bashkinë Belsh ka vetëm një shkollë të mesme gjimnaz I përgjithshëm që frekuentohet nga nxënës që vijnë nga të gjitha njesitë.

Shkolla është e rikonstruktuar vitet e fundit duke patur kushtet optimale

Qëllimi I planit në arsimin e mesëm të përgjithshëm:

- Të rritet cilësia e procesit mesimor
- Të ulët braktisja shkollë
- Nxënësve në aktivitete zhvilluese duke krijuar një sistem të Arsimit të mesëm me funksional, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt të ardhmes.

Objektivat Specifike

- Përmirësimi i infrastruktures mesimore dhe digjitale në gjimnaz.
- Ulja e nivelit të braktisjes shkollë dhe rritja e pjesëmarrjes aktive.
- Fuqizimi i rolit të keshilltarit shkollor dhe mbështetja psikologjike për nxënësit.
- Rritja e rezultateve të nxënësve në provimet e maturës.
- Rritja e bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin.
- Rritja dhe realizimi i aktiviteteve të ndryshme
- Trajnime për mësuesit në përdorimin e metodave bashkëkohore
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme gjatë gjithë vitit mesimor.
- Përfshirja në aktivitete të nxënësve me rrezik braktisje
- Pjesëmarrja me e lartë e prindërve në procesin edukativ

9. Planifikimi I burimeve financiare

Te ardhurat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar:

Te dhënat financiare për shërbimin e Arsimit Parauniversitar.

Ky seksion përmbledh informacionin financiar qe lidhet me funksionimin dhe zhvillimit e sistemit te arsimit parauniversitar ne nivel Bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin Bazuar ne te ardhurat përmes transferues specifike dhe te përgjithshme te siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore.

Transferimet specifike mbulojnë zërat si me poshtë:

- Arsimi parashkollor: përfshinë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës se kopshteve dhe shkollave, si dhe mbështetjen për përfshirje te fëmijëve nga grupet vurneralbe.

Te dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e me pashme për të mundësuar analize krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e planifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

Për periudhë 2025 – 2028, buxheti total i planifikuar për arsimin parauniversitarë është 48,200 mijë lekë, të paraqitura si më poshtë:

Llogaria Ekonomike	Aktivitetet	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Tërtali
600+601	Shpenzime Personeli	3,600	3,700	3,700	3,700	14,700
602	Shpenzime Operative	3,000	3,500	3,500	3,500	13,500
231	Investime me Bashkëfinancim	5,000	5,000	5,000	5,000	20,000
Shuma						48,200

Plani I Veprimit

Qëllimi 1 (Q1) - Sigurimi i një mjedisi arsimor të sigurt, funksional dhe gjithëpërfshirës

Objektivi specifik O1. Të sigurohet ofrimi i shërbimeve mbështetëse në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke përfshirë pagesat e personelit, mësues në arsimin parashkollor dhe personelit ndihmës në kopshte dhe shkolla, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, funksionimin e sistemeve të ngrohjes, furnizimin me kancelari, mjete didaktike, dokumentacion dhe transport.

Aktivitetet	Perioda e zbatimit	Përgjegjës	Partner	Burimet Financiare	Tregues
Mbështetja me pagesën dhe sigurimin punonjësve e arsimit (parashkollor, baze dhe atij të mesëm)	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	Nr. i punonjësve të mbështetur financiarisht; Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopësht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë shërbimi i arsimit parashkollor.
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet,	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transferte e pakushtëzuar	Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, mirëmbajtje kaldajash, elektroshtepiakësh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zvrave)
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike,	Shkollat, operatore të higjienës, kopshtet	Buxhet vendor, transferte e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike,	Operatore të energjisë	Buxhet vendor + transferte specifike	Nr. i institucioneve me sistem funksional ngrohjeje
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxheti Vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kohauidimi i fikseve të zjarrit	2025-2028	Zyra e Emergjencave,	Zjarrëfikësja, NjA	Buxheti Vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale
Furnizimi me dokumentacion administrativ institucionet arsimore për institucionet arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxheti Vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion
Furnizimi me mjete didaktike për institucionet arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Kopshtet MAS	Buxheti vendor + donacione, prindërit	Nr. i shkollave të pajisura me mjete didaktike
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike,	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operator të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjencave	Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit

Objekti i veprimtarisë 01.2 të investimit në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përmes ndërtimit ose rikonstruksionit të kopshteve dhe institucioneve arsimore, pajisjes me mobilie, si dhe ngritjes së një sistemi elektronik për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të institucioneve arsimore.

Aktiviteti	Perioda e zbatimit	Përgjegjës	Partner	Buxheti Financiare	Tregues
Investime në infrastrukturë e institucioneve të arsimit parashkollor Mirëmbajtja e godinave të Kopshteve, ndërtimi i kopshtit Publik Beish.	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Qeveria shqiptare + Bashkia + Donator	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruara përmirësimi i kushteve.
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit baze dhe atij të mesëm Mirëmbajtja e godinave: shkollore, rikonstruksion dhe mirëmbajtja e terreneve sportive, rikonstruksion i shkollës Kujan	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Drejtoria e Arsimit	Buxheti i Bashkisë	Nr. i infrastrukturës shkollore e rikonstruktuar dhe e mirëmbajtur
Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat në kuadër të planit për përmirësimin të arsimit parauniversitar	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Kopshtet /shkollat	Buxheti i Bashkisë	Një regjister i shërbimit për arsimim parashkollor, arsimin baze dhe atë të mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna.

Qëllimi 2. 221. Mësimet për zhvillimin e plotë të fëmijëve përmes edukimit cilësor dhe përkujdesjes së integruar

Objekti i specifik O2.1 Të përmirësohet cilësia e edukimit në institucionet parashkollore përmes mbështjës së kushteve me mjete dhe organizimit të trajnimeve për edukatorët dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit për të ofruar një edukim të hershëm gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor

Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partner	Burimet Financiare	Tregues
Paisje me materiale didaktike, kompjuter dhe trajnime për edukatorët	Cdo vit	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MAS partner zhvillimi	Buxhet vendor	Nr. I fëmijëve vajza djem nga familjet në nevoj dhe grupet vunerabel që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet.
Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetjes për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.	Cdo vit	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MASR institucionet arsimore, ASCAP	Buxhet vendor	Nr. I edukatoreve të trajnuara përmirsimi të praktikave të mësimdhënies

Objekti i specifik O2.2 Te forcohet përkujdesia sociale për fëmijet përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale: krijimit dhe fuqizimit të strukturave menaxhuese pjesëmarrëse (këshillat e prindërve dhe bordet e shkollës), si dhe mbështetjes së nxënësve nga familjet në nevojë apo me rezultate të larta.

Aktiviteti	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partner	Burimet Financiare	Tregues
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore	OJQ sociale MAS	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) me ndihme sociale;
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat	2025-2028	ZVA, Njësia përgjegjëse për arsimin Bashkia	Administratoret e Njësive Administrative; këshilli bashkiak: Kopshtet; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive. Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nene/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore; Njësia përgjegjëse për shërbimet	Kopshtet OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	Nr. i fëmijëve (vajza/djem, nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko-social.
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale.	Shkollat Njësive Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkelqyera	2025-2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale.	MAS, mësues, komuniteti	Buxhet vendor + shperblime nga MAS	Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkelqyera të mbështetur

Objektivi specifik O3.1 Të organizohen rregullisht veprimtari kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuëse, si: ngjarje artistike, ekspozita, ditë ndërkombëtare tematike, aktivitete mjedisore dhe lokale, për të nxitur zhvillimin e aftësive dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.

Aktiviteti	Perioda e zbatimit	Përgjegjës	Partner	Burimet Financiare	Tregues
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojera edukative dhe mbishetje emocionale në institucionet e Arsimit	Cdo vit	Shkollat/Kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor + Mbështje donatorësh	Numër dhe larmija e aktiviteteve, përfshirje gjithëpërfshirëse
23-30 Shtator - Javë Evropiane e Sportit Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore) * Ushtrime në natyrë (gimnastike) * Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, ciklizem gara me biçikleta midis shkollave					
20 Nëntor - Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (kam të drejtë të luaj) Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët "Të drejtat e mia" "Une mbroj të drejtat e mia" (bisedë)					
Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor) Bisedë me fëmijët					
Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe (22 nëntor) * Postera me gjuhën shqipe & ilustrime * Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)					
28-29 Nëntori- Dita e Pavarësisë dhe Dita e Çlirimit Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor). Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta. Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta) * Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK					
Dita Botërore e Gjuhës Amlare Vizite në bibliotekë (21 shkurt)					

14 Mars " Dita e Verës" *Panairi që realizohet nëpër shkollë dhe kopshte me: *Ushqime tradicionale *Punime artistike dhe krijuese *Lojëra argëtuese					
Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) "Uji është jetë" (Postera, eksperiment me ujë)					
22 Prill Dita Ndërkombëtare e Tokës *Në këtë ditë organizohen aktivitete sensibilizuese si: *Pastrimi i ambienteve përreth shkollës / komunitetit *Mbledhje pemësh apo lulesh *Punime dhe postera me mesazh për Tokën *Diskutim për mbrojtjen e natyrës dhe riciklimin					
Prill - Maj - Java Olimpikë *Lojë të ndryshme sportive (stafeta me flamur, topa) *Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe *Gara me biçikleta, Kampionat Futboll- Volejboll zhvillohet midis shkollave, futboll djem, volejboll vajza- djem. *Dita e balonave-organizim midis shkollave për ngutjen e balonave					
1 Qershor- Dita Ndërkombëtare e fëmijëve ku organizohen aktivitete të ndryshme në të gjitha kopshtet.					
Miss Aferdita - Një udhëtim midis natyrës, mitit dhe kulturës. Kjo festë përfshin një sërë aktiviteteve artistike kulturore, ku përfshihet historia tradita dhe zakonet e zonës së Dumresë.					

Plani i investimeve kapitale

Lista e projekteve të investimeve për periudhën afatmesme 2025-2028 (në mijë lekë)

Emërtimi i Projektit	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Totali
Ndërtimi i Qendres Rinore					
Ndërtimi i kopshtit publik Belsir					
Rikonstrukcion dhe mirembajtja e terreneve sportive					
Rikonstrukcioni i shkolles Kajan					

10. Përfshirja sociale dhe pjesëmarrja e fëmijëve romë dhe egjiptian në arsimin bazë.

Në analizën e shërbimit të Arsimit bazë, një aspekt me rëndësi të vecantë është vlerësimi i shkallës së përfshirjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve nga komuniteti romë dhe egjiptian. Të dhënat në nivel vendor tregojnë se në disa shkollë urbane dhe periferike ka një përqindje të ulët të fëmijëve romë dhe egjiptian. Për këtë arsye është thelbësore forcimi i bashkëpunimit mes shkollave, njësive të vetëqeverisjes vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe fëmijëve për tu mundësuar:

- Regjistrimi në kohë të fëmijëve romë dhe egjiptian në klasën e parë
- Ndjekjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes së tyre në procesin mësimor
- Angazhimi i ndërmjetësve komunitarë për të forcuar shkollë-familje

11. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetshe në planin e veprimit dhe të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm.

Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin kopshtesh (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Efiçienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

- **Planifikimi i vlerësimit të progresit**

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxh stor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë e pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe, përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara

2. Vlerësimi ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

0-Aktiviteti nuk ka nisur.

1-9 - Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

MIRATOHET

KRYETARI BASHKISE

Arif TAFANI

